

**RAPORT TEKNIK I INSTALIMEVE**  
**HIDROSANITARE**

***OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION I KOPSHTIT ME DREKE, PATOS”***

OBJEKTI: *“Rikonstruksion i Kopshtit me dreke, Patos”*

ZHVILLUES: *Bashkia Patos*

VENDODHJA: *Patos*

PROJEKTUES: *D.P.ZH.T & P*

## 1-INSTALIMET HIDROSANITARE

### LLOGARITJA E SASISE SE UJIT PER RRJETIN E BRENDSTEM

Prurjet e ujit per rrjetin e brendshem te furnizimit me uje, percaktohen nga lloji i objektit qe do te furnizohet, karakteri i tij dhe specifikat e vecanta te kerkesave funksionale per uje. Llogaritja e sasise se pergjithshme te ujit per cdo konsumator te vecante, te grupuar ose jo, behet mbi bazen e konceptit te shumatores se ekuivalenteve per pjesen llogaritese te rrjetit dhe te normave te ujit per konsumator, te cilat jepen ne kapitullin e furnizimit me uje te rrjetit te jashtem. Faktoret qe ndikojne dhe qe merren parasysh ne llogaritjen e prurjeve te rrjetit te brendshem jane,

- Njesite ekuivalente;
- prurjet specifike;
- koeficientet e jonjËtrajshmerise se perdorimit te njekohshem dhe uniform te ujit;
- presioni i perdorimit minimal te pajisjeve;
- diametrat standarde te pajisjeve hidrosanitare;

Me poshte jepen ne menyre tabelare lidhjet korelative te elementeve te mesiperme:

**Njesite ekuivalente, prurjet specifike, presioni i perdorimit dhe diametrat e pajisjeve hidrosanitare.**

**Tabela 14**

<b>Nr</b>	<b>Emertimi i pajisjeve hidrosanitare</b>	<b>Diametri mm</b>	<b>Njesia ekuivalente</b>	<b>Prurja Specifike l / sek</b>	<b>Presioni normal i perdorimit m</b>
1	Pjata larese	15	1.0	0.2	2.0
2	Bateri vaske banje me pergatitje lokale uji te ngrohte	15	1.0	0.2	3.0
3	Bateri vaske banje me pergatitje te perqendruar uji te ngrohte	15	1.5	0.3	3.0
4	Dush	15	1.0	0.2	3.0
5	Kasete shkarkimi WC	10	0.5	0.1	2.0
6	Larese duarsh, kembesh, bide	15	0.35	0.07	2.0
7	Pisuar individual	10	0.17	0.035	2.0
8	Pisuar ne seri	15	0.25	0.05	2.0

**Koeficienti i punimit te njekohshem te pajisjeve hidrosanitare**

**Tabela 15**

<b>Nr.</b>	<b>Emertimi i pajisjeve hidrosanitare</b>	<b>Koeficienti i punimit te njekohshem</b>
1	Larese duarsh ne grup, dushe te perbashketa, çezma me rrjedhje te vazhdueshme, pisuare me rrjedhje te vazhduar	1.0
2	Klozete	0.3
3	Larese duarsh te veçuar	0.3 – 0.6
4	Bide	1.0
5	Dushe	0.6

Sasia llogaritese e ujit ne ndertesat industriale dhe ushqimore, per nevoja prodhimi dhe teknologjike, percaktohet vecmas, mbi bazen e nevojave konkrete te ujit , per te perballuar procesin prodhues dhe teknologjik, mbi baze te nje projekti te vecante. Normat e konsumit te ujit per nevoja kunder zjarrit shtohen ne perputhje me normativat e vecanta te MKZ, te miratuara nga Keshilli i Ministrave.

- Permasimi i tubacioneve te rrjetit te brendshem te furnizimit me uje dhe llogaritja e humbjeve te presionit per tubat PE

Per llogaritjen e diametrit te brendshem te rrjetit te furnizimit me uje rekomandohen shpejtesite sipas Tabeles 16.

<b>Diametri i tubit</b> <b>mm</b>	<b>Shpejtesia ekonomike</b> <b>m / sek</b>
16 – 32	0.6 – 1.2
40 – 90	0.9 – 1.7
mbi 90	1.2 – 2.0

Gjate llogaritjes se diametrave te rrjetit te brendshem, duhet te shfrytezohet maksimalisht presioni i siguruar ne rrjetin e jashtem ne piken e lidhjes se tij me rrjetin e brendshem, qe do te thote te synohet drejt shfrytezimit maksimal te presionit te siguruar ne dobi te zgjedhjes se diametrave me te vegjel , te cilet do te siguronin kosto me te ulet te ndertimit te rrjetit te furnizimit me uje.

Ne menyre orientuese, paraprakisht per zgjedhjen e diametrave te tubave per rrjetin e brendshem te furnizimit me uje, ne varesi te shumes se njesive ekuivalente qe permban sistemi qe do te furnizohet, mund te perdoret Tabela 17 , nepermjet te ciles percaktohen diametrat e degezimeve per pajisjet.

#### **Diametrat e tubacioneve te degezimeve per shumen e njesive ekuivalente**

**Tabela 17**

Shuma e njesive ekuivalente	1	3	6	12	20	30	40	50	60
Diametri i tubit mm	16	20	25	32	40	50	63	75	90

**Hartoi:** Ing. Ermenita Mici